VENDIM
Nr.633, datë 24.12.1999

PËR SHTESË FONDFI PËR HIDROVORET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr.8379, datë 29.7.199, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në buxhetin e vitit 1999 t'i shtohet një fond prej 30 milionë lekë për likuidimin e energjisë elektrike dhe drejtoritë e ujrave për vitet 1998-1999 dhe për përballimin e situatës për rritjen e gatishmërisë së elektropompave të hidrovoreve.

2.Ky fond përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta